INFORMOHU & KERKO!

Si shtetas në kontakt me policinë, ti ke të drejtë:	Si punonjës policie, ndaj shtetasve që bien në kontakt me ty, ti ke për detyrë:
Ta konsiderosh punonjësin e policisë si mbrojtësin e të drejtave të tua në përputhje me ligjin.	Të mendosh e të sillesh si mbrojtës i të drejtave të shtetasve sipas ligjit.
Nëse je i / e mitur , pra nëse nuk i ke mbushur akoma 18 vjeç, duhet të komunikosh me punonjësin e policisë vetëm në prani të prindit apo kujdestarit tënd. Nëse ata nuk mund të jenë prezent, ke të drejtë të kërkosh praninë e nje psikologu gjatë komunikimit me punonjësin e policisë.	Të respektosh parashikimet dhe procedurat ligjore për përcaktimin e moshës. Të mos nisësh asnjë lloj procedure intervistimi apo pyetjeje me të miturin pa praninë e prindit, kujdestarit apo psikologut.
Në ambjentet e policisë të të plotësohen nevojat bazë: përdorimi i tualetit, ushqim, ndihmë mjekësore e menjëhershme, transport në qendrën mjekësore më të afërt nëse ke dhimbje, ose trajtohesh rregullisht për probleme shëndetësore.	T'i krijosh kushte për plotësimin e nevojave bazë, ose ta lejojsh të përdorë burimet e veta.T'i sigurosh transportin dhe qasjen e menjëhershme tek shërbimi mjekësor më i afërt. Të mos e mbash në ambjentet e policisë përtej afateve të lejuara.
Në ambjentet e policisë të të informojnë hollësisht dhe në mënyrë të qartë për procedurat, rolin dhe pozicionin e çdo personi që komunikon me ty.	Ta informosh me nje gjuhë të kuptueshme mbi emrin tënd, pozicionin që ke, dhe mbi qëllimin dhe rëndësinë që ka komunikimi i shtetasit/es me ty.
Të të dëgjojnë me kujdes, pa të paragjykuar. Të kuptojnë situatën në të cilën ndodhesh dhe të të informojnë qartazi se ç'parashikon legjislacioni shqiptar në lidhje me këtë situatë.	Ta dëgjosh me kujdes, pa e paragjykuar atë çfarë të thotë, dhe ta informosh se çfarë parashikon legjislacioni shqiptar në lidhje me situatën që ndodhet shtetasi/ja.
Nëse punonjësi i policisë apo personat e tjerë prezent, mendojnë se mund të jesh viktimë e krimit të trafikimit, ke të drejtën e intervistimit nga një punonjës i policisë i specializuar për çështjet e trafikimit.	Ta informosh mbi procedurën e identifikimit të viktimave të trafikimit dhe qëllimin e intervistimit. Ta shoqërosh tek punonjësi i trafiqeve për realizimin e proçesit të intervistimit.
Ti ke të drejtën të ndihmohesh si viktimë e krimit të trafikimit edhe nëse nuk bën kallzim \ deklarim me shkrim ndaj atyre që të kanë dëmtuar.	Të mos bësh presion për marrjen e kallzimit, por te bashkëpunosh me institucionet e mbrojtjes sociale për dhënien e ndihmës.
Ti ke të drejtën të kërkosh drejtësi dhe të bashkëpunosh me punonjësit e policisë dhe autoritetet e zbatimit të ligjit për dënimin e trafikantëve.	Të informosh për procedurat, rolin dhe përfshirjen e shtetasit në marrjen e kallzimit, hetimin dhe gjykimin e çështjes ndaj trafikantit.
Nëse bashkëpunon për dënimin e trafikantëve, ti ke të drejtën ligjore të kërkosh dëmshpërblim dhe mbrojtje të veçantë.	Të informosh për procedurat ligjore të marrjes së dëmshpërblimit dhe mbrojtjes së veçantë në bazë të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

IOM • OIM

SHËNIM: Pikëpamjet e autorit te shprehura ne këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA−ve apo të Qeverisë së SHBA−ve dhe/ose te Organizates Nderkombetare per Migracionin (ONM).